



Republika e Serbisë

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS  
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT FILLOR

viti shkollor 2011/2012

## TESTI 3

# GJUHË SHQIPE

### UDHËZIM PËR PUNË NË TEST

Testin të cilin duhet ta plotësosh i ka 20 detyra, kurse për punë janë parashikuar 120 minuta. Secilën detyrë së pari lexoje me kujdes mendo për këtë se çfarë kërkohet në të. Së pari zgjidhi ato detyra të cilat janë më të lehta për ty, e më vonë zgjidhi ato detyra të cilat për ty janë më të vështira.

Lexoje me kujdes tekstin e secilës detyre, sepse në të është shpjeguar në çfarë mënyre duhet të përgjigjesh. Në detyra prej teje kërkohet të rrethosh shkronjën para përgjigjes së saktë, t'i bashkosh pjesët e përgjigjes, të shkruash diçka etj.

Gjithnjë përdor emërtimet e plota me rastin e zgjidhjes së detyrave, shkurtesat nuk janë të lejueshme (psh., duhet të shkruash: rrethanori i vendit, e jo rr.v.).

Në katrorin i cili gjendet në anën e djathtë të detyrës mos shëno asgjë, ajo është hapësirë në të cilën shënohet numri i pikave.

Në këtë dhe në faqen e fundit mos shkruaj asgjë.


Testin duhet ta plotësosh me **stilolaps**. Gjatë punës mund të përdorësh lapsin grafit dhe gomën. Detyrat zgjidhi së pari me laps grafit sepse kështu ke mundësi që, nëse e vëren gabimin, këtë gabim ta korrigjosh.

Para se ta dorëzosh testin, verifiko përgjigjet tuaja edhe njëherë, e pastaj të gjitha përgjigjet shkruaji me stilolaps.

Përgjigjja e cila është shkruar vetëm me laps grafit nuk do të pranohet, por as përgjigjja të cilës i është hequr vizë dhe e cila është korrigjuar me laps kimik.

Nëse e mbaron testin më herët, dorëzoja testin arsimtarit kujdestar dhe dil ngadalë që të mos i pengosh shokët.

**Të dëshirojmë sukses në provim!**



1. Secila nga pjesët kryesore të njëpasnjëshme, në të cilat ndahet lënda e një libri, e një rregulloreje është:

- a) citat  
b) parathënie  
c) kapitull  
d) përmbajtje

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

2. Emrat në gjuhën shqipe ndahen në katër lakime. Shiko tabelën.

Lakim i parë	Lakimi i dytë	Lakimi i tretë	Lakimi i katërt
Gj. mashkullore		Gj. femërore	Gj. asnjëanëse
Emrat me -i <i>televizor-i,</i> <i>libr-i</i>	Emrat me -u <i>brisk-u,</i> <i>mik-u</i>	Emrat me -a, -ja <i>fush-a,</i> <i>fletor-ja</i>	Emrat me -t, -të, <i>krye-t,</i> <i>të ri-të</i>

Në tabelën e dhënë detyra juaj është të gjeni:

- a) Në cilin lakim bëjnë pjesë emrat e gjinisë mashkullore? \_\_\_\_\_  
b) Në cilin lakim radhiten emrat e gjinisë femërore? \_\_\_\_\_  
c) Cilit lakim i takojnë emrat e gjinisë asnjëanëse? \_\_\_\_\_

3. Uji është një pjesë përbërëse e planetit tonë. Ai është një substancë pa shije që mbulon rreth  $\frac{3}{4}$  e sipërfaqes së tokës... 2 % e ujit të tokës është në formë të mirë, porse mbetet vetëm rreth 1 % e krejt ujit të tokës i përshtatshëm për përdorimin nga njerëzit dhe kafshët. Ky ujë është kryesisht i liqeneve, lumenjve dhe i burimeve të ndryshme në tokë. Një sasi e vogël e ujit ndodhet vazhdimisht në atmosferë, në trajte avulli.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego se çfarë lloji i tekstit është :

- a) tekst letrar  
b) tekst joletrar

4. Duke dëgjuar për ndotjen e ambientit shkencëtarët kanë konstatuar se në Kosovë nga Obiliqi lëshohen në ambient me shumë gazra të dëmshme për një banor nga secili shtet tjetër në rajon. Obiliqi është bërë njëri nga ndotësit më të mëdhenj të gazrave të cilët kontribuojnë në ashtuquajturit “ndotja globale”.

Pra, në Kosovë në vitin 2010 janë hedhur në ambient të hapur më shumë se 15.5 tonë dioksid të karbonit për një banor. Në krahasim me vendet e tjera të rajonit Kosova prinë në këtë drejtim.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe nga ky tekst nxirr 3 fjale kyçe apo vendimtare.

5. Valoni: - Mami, nesër mbrëma, pas mësimit, në ora shtatë të mbrëmjes më duhet të shkoj në shkollë.  
 Nena: - Jo... nesër na duhet të shkojmë te tezja, sepse ajo është e sëmure keq.  
 Valoni: - Mami, po ne kemi aheng, nesër mblidhemi të gjithë shokët...  
 Nena: - Dëgjo zemër, nesër nuk mundemi sepse tezja është e sëmure dhe ajo ka kërkuar të të shohë ty... se te do shumë.  
 Valoni: - Mami të lutem! – mua tash më duhet t`u jap shokëve një përgjigje.  
 Nena: - Dëgjo njëherë. Ajo po vdes. A nuk dëshiron që ta shohësh ndoshta për here të fundit. Ndoshta kur të të shohë ty, do te i zbutet dhembja. Ti fort mirë e di se ajo të do, si djalin e saj.

Lexo tekstin lartshënuar dhe trego se çfarë teksti është:

- a) përshkrues  
 b) autobiografik  
 c) dialog

6. Shkruani:

- a) Fonemat zanore te fjalët: *nënë, yll, diell, përrallë, gërrryej.*

---

- b) Fonemat bashkëtingëllore te fjalët: *hënë, rrugë, deri, derri*

---



7. Duke i rishkruar me shkronja dore fjalitë, vendosi shenjat e duhura të pikësimit.

- a) Im atë ka qenë gjithmonë baba i dhembshur

---

- b) Kush e ka përgatitur këtë ëmbëlsirë

---

- c) E gëzofsh ditëlindjen

---



8. Para teje është një formular. Duhet ta plotësosh me të dhënat e sakta të shokut tuaj.

Emri e mbiemri .....

Datëlindja, vendlindja .....

Gjinia .....

Profesioni .....

Kombësia .....

Adresa e saktë .....

9. Teksti 1

- Eh, Ç'vapë që bën sot - mendoj me vete Garneta.

Është me të vërtetë dita me e nxehtë e verës.

Qielli ishte pa asnjë re dhe shkëlqente në një ngjyre të kaltër. Here-here ai errësohej pa prituri dhe ne te shfaqeshin re te ngarkuara me shi e vetëtimë. Po, prapëseprapë, s`binte s`binte shiu.

Çdo mbrëmje, pas darke, babi i Garnetes dilte përjashta shtëpisë dhe e hidhte shikimin lartë në qiell. Pastaj i ngulte sytë poshtë, në arat e tij.

Jo, thoshte ai, as sonte s'do te kemi shi...

Teksti 2

Na ishin tre vëllezër, na kishin një motër. Motrën e vunë shërbëtores te prifti. Kaloi një kohë e thanë vëllezërit: More, na mori malli për motrën. Duhet të shkojmë ta shohim si është e si ia kalon te prifti...

.....  
Qerosi shtri, i demek të flinte, po prifti jepte e merrte me urinë. E ç'benë? Del jashtë në kopsht e fillon te haje lakra! Grap, grap , grap !...

Lexo me kujdes dy tekstet e lartshënuara dhe trego se cili tekst është:

a) tekst letrar (gjuhës së shkruar)

b) tekst joletrar (gjuhës së folur)

**10.** 1. Do te shkojm ne teater per ta shiku dremen toka jone te kol Jakoves.

2. Un do ta kasha tregu se cka ka ndodh por as un se di.

Fjalitë e lartshënuara shkruaji drejte sipas normave drejtshkrimore.

1. \_\_\_\_\_

2. \_\_\_\_\_

**11.** Shiko me kujdes fjalët e mëposhtme dhe nënvizo vetëm pjesët e pandryshueshme të ligjëratës:

a) në, nën, nëpër, për pa

b) libër kompjuter top

c) dhe, edhe, ndërsa, veç, veçse

ç) i bukur, i mirë, i sjellshëm

d) jo, jo se jo, jo që jo,

dh) vetja, i tyre, çfarë?

e) ah, oh, uh, bobo, ububu

ë) sa, shpejt, këtu

**12.** Nga këto rrënjë formoni fjalë:

Fletë \_\_\_\_\_

bukuri \_\_\_\_\_

Ditë \_\_\_\_\_

**13.** Lidh fjalët të cilat kanë kuptimin sinonimik (d.m.th. janë sinonime)

i ngathët

çati

pullaz

i urryer

i mirë

i shkathët

i keq

udhë

rrugë

ndërtoj



- 14.** Nënvizto rrokjet e theksuara te fjalët e dhëna më poshtë:  
Barium, Letërsi, Molla, Dredhëza, Fyelli, Dielli
- 15.** Lexo emrat e poshtë shënuar dhe ndaj emrat konkret nga ata abstraktë.  
P.sh: dhembje, bankë, urrejtje, dërrase, tavoline, dashuri, pikëllim, dritare, çati, vuajtje.
- 16.** Numrat para emrit të personazheve shkruaj në vijat përballë titullit të veprës përkatëse. Një personazh është më tepër.
- |                |   |
|----------------|---|
| 1. Tana        | “Nita....._____”                        |
| 2. Asim Vokshi | “Këngët e Milosaos” _____               |
| 3. Zefi        |   |
| 4. Vangjeli    | “Katërmëdhjetë vjeç dhëndër” ....._____ |
| 5. Hajrija     |   |
| 6. Nita        |   |
| 7. Milosao     |   |
| 8. Xhemal Kada |   |
| 9. Rina        |   |
- 
- 17.** Armët i kam pranë, po s`luftoj dot. Kitarën e kam pranë, po s`këndoj dot. Po vdes... këmba ime nuk do të shkel më kurrë mbi shkrepat e Sulit. Meteorët e përgjakur s`patën vend për këtë lëng të sertë që rrjedh nga plagët dhe që është jeta ime. Se gjaku i kombit tim është shprishur e rrjedh nëpër Ballkan e nëpër Evropë, kudo që ngre krye liria.
- Ne jemi gladiatorë, që shpërthyem arenën. Karpenisi. Mbi kokën time djeg dielli i huej i Eladës. I verdhë si limon ky qiell. Mbi buzën time po rreshken kripërat e fundit. S`kam një bulë ujë dhe zemra po më çahet nga malli. Nuk mundem të këndoj. Fytyra e Krizesë dhe e tim biri buzëqeshin përtej pyllit të gjelbër me ullinjë.
- Ku jeni? Era gënjeshtare lot me mua dhe shpërndan mall e këngë të vjetra lufte, si atëherë kur ndoreshim tek Pesë Pusët, në Qafë, apo në kështjellën e Shën Venerandës.
- Ku vemi? Ky vig që lëkundet më kujton djepin e nënës, që më merrte gjithmonë në shpinë. Me djepin tim e të Konstandinit im`ë u çonte barut luftëtarëve. Nga gjumi më zgjoi një krismë, dhe një krismë po më vë në gjumë.
- ... Më dhemb diçka. Diçka se kreva...  
po mbërrimë. Hapuni mporta, pa çka se çepallat e mia po mbyllen dhe shokët nuk i shquaj dot! Më varrosni pranë fortifikatës së Gjergj Kastriotit, që hija e tij të më qetësojë...  
Teksti i dhënë më lartë duhet të lexohet me kujdes dhe të jepen përgjigjet e sakta në pyetjet e radhës. Dalloni cilit lloj të tekstit i takon ky fragment?
- a) tekstit përshkrues;  
b) tekstit narrativ;  
c) monologut;  
d) dialogut.

- 18.** Zhyl Vern(1818-1905) është një nga shkrimtarët më të mëdhenj francez dhe i njohur në botë për librat e tij të karakterit fantastiko-shkencor. Shumë nga ëndërrimet dhe parashikimet e tij sot janë bërë realitet. Disa nga romanet e tij më të njohur janë : “Pesë jave me balon “ , “ Bijtë e kapitenit”, “Ishulli misterioz” etj.

Edhe sot lexohet me ëndje Zhyl Verni nga lexues të shumtë, veçanërisht nga të rinjtë.

Lexo tekstin e lartshënuar dhe trego se çfarë teksti është:

- a) informative
- b) biografik
- c) shkencor

- 19.** Kënga për nipin e vogël

( Vehbi Kikaj)

Edhe zogu i vogël erën mallkon,  
Kur kjo e tret ndhe t’huaj,  
As peshku i vogël lumin se don  
Kur e hedh n’zallin pa uje.

.....  
Nje fushe me lule. Ngasin qupezat  
Lule kerkojne cdo dite  
Vorfnjake jane, i mbledhin tubezat  
Per t’pasun- m’treg me I shit  
Ti vjollcat I don. Pse rrin sot  
Pse s’shkon si femijte tue nga?  
Lule nuk lyp - mu duk se m’thot  
Gezim kush n’zemer ska

.....  
.....  
Do t’bahemi t’pasun, m’tha kete vere,  
Gjithcka do te kete per ne  
Nuk di pse qau kur e pieta atehere

A mujme vendlindjen me e ble? ...

Lexo këto vargje dhe përcakto gjininë e këtyre vargjeve :

- a) Poezi satirike
- b) Poemë
- c) Poezi refleksive

- 20.** Ne ç’kopshte me lule ke qëndruar vallë

S’të vjen keq për mua ? S’të vjen mallë për djalë

O engjell i bukur, mos mëno në botë

Kthehu të të shohë, të na mbeten lot.

Strofën e shkëputur nga një poezi e bukur lexoje dhe duke shkruar përgjigjet në vizat e dhëna, trego:

- a) titullin e poezisë \_\_\_\_\_
- b) emrin e autorit \_\_\_\_\_
- c) llojin e poezisë \_\_\_\_\_

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

# Rezultati në testin e gjuhës shqipe

Vërejtje: Nxënësit NUK e plotësojnë këtë faqe!  
Këtë faqe e plotëson Komisioni!

Numri i përgjithshëm i pikave

		,	
--	--	---	--

Komisioni:

- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_
- \_\_\_\_\_

Numri i pikave për secilën detyrë.

Numri i detyrës	E pplotësuar	0 pika	0,5 pikë	1 pikë
1.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
2.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
3.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
4.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
5.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
6.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
7.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
9.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
11.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
13.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
15.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
16.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
17.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
18.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
19.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
20.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

Shkruaj ✗ në vendin përkatës.

Numri i identifikimit (Shifra e nxënësit)	
Shkolla	
Vendi	
Emri dhe mbiemri i nxënësit	